



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 28.03.2019 në ora 18:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Zenun Pajaziti, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

Munguan: Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Adem Hoxha.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu-Kodra, kryetare Komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

Kryetarja, paraqiti opinionin ligjor lidhur me Projektligjin dhe tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë Projektligj, nuk janë të rregulluara me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Andaj, konstatoj se Projektligji nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pra janë dy amendamente, të cilat i lexoi dhe e hapi diskutimin!

Zenun Pajaziti, pyeti se a është në dijeni dikush në Komision se çfarë qëndrimi ka marrë Komisioni për Legjislacionin, në lidhje me këtë projektligj, a ka ndonjë opinion që fuqizimi i këtij ligji mund të ketë pasoja të tjera, që do të rrjedhin pas ndonjë ankese, ndonjë pasojë ligjore dhe financiare sepse prej Qeverisë nuk pashë ndonjë vlerësim të tillë.

Armend Zemaj, tha, për të dhënë një opinion, duhet ta kemi një analizë dhe në mënyrë analoge me ligjet tjera, pra komplikimet ligjore, por sot nuk mundet me e nxjerr asnjë Komision, komisioni ynë nuk e ka këtë kompetencë dhe në bazë të fushëveprimtarisë e japim opinionin, me legjislacionin të BE-së nuk rregullohet dhe ne jemi në rregull.

Fatmire Kollçaku, tha se pa e sjell në Kuvend Projektligjin, analizën është dashur ta bëjë Qeveria sepse ka një mori ekspertësh dhe zyrtarësh. Kur është sjell Rezoluta në Kuvend, Qeveria është dashur të merret në të gjitha fazat me efektet që prodhon ky ligj, sepse për ligjin për paga e kanë sjell klauzolën që hyn në fuqi pas 9 muajve, kurse në këtë rast, Qeveria vjen me një nguti që se ka kërkuar rezoluta, thjesht si me e lut punën, se si dikush me e dërgua në Kushtetuese ankesën dhe mos të zbatohet. Kjo është një dilemë që vendoset para nesh.

Milaim Zeka, pavarësisht se ne si komision nuk kemi kompetenca për ta ndryshuar ligjin, por kemi kompetenca me i paraqit shqetësimet tona, Qeveria jonë nuk ka tubuar ekspertë dhe juristë për të bërë një analizë dhe për të bërë një fushatë dhe ti bind ose jo deputetët, për mënyrën si është sjell në mënyrë të jashtëzakonshme, brenda disa orëve, me u miratua në dy lexime. Kam frikë se kjo mund të na del dardhë me bisht.

Pas diskutimeve, kryetarja e hodhi në votim Projektligjin dhe konstatoi, se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja, në lidhje me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2019-2023), tha se duke pasur parasysh se është dokument shumë voluminoz, me qëllim të kursimit të kohës dhe mjeteve, nga Sekretari i Kuvendit na kanë pyetur nëse ne pajtohemi që të kemi vetëm version elektronik të këtij dokumenti.

Siç e dini, ne jemi Komision funksional, lidhur me këtë dokument gjatë ditëve të ardhshme do të mbajmë një mbledhje për shqyrtimin e tij, andaj, nëse pajtoheni, ne do të punojmë vetëm me version elektronik.

Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan që të përcillet dokumenti në mënyrë elektronike, por kërkuan që të iniciohet një kërkesë tek sekretari i Kuvendit sepse rrjeti i internetit duhet të jetë më efikas dhe po kanë probleme.

Mbledhja përfundoj në ora 18:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetare e Komisionit
Blerta Deliu-Kodra
